

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRI E TËRËSHTËSIAE / MINISTRI I PARËSHTONIAE DHE INFRASTRUKTURËS MINISTRIEVO ZHIVOTNE BUDIT, PRISTORNOGA PLANIRANJA I IZ ODRUJAVANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jeditsica Org.Unit	DPHNB
Nr i Faqeve Rr. Stranica No. Pages	/
Nr i Prot. Broj Prot. Prot. No.	8657/24
Data Datum Date	31.12.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në mbështetje të Nenit 12 paragrafit 3, nën-paragrafit 3.1 të Ligjit nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (Gazeta Zyrtare nr.1, 17 janar 2022) dhe Nenit 9 paragrafit 5 të Statutit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për periudhën e përkohshme, Kuvendi i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës miraton:

RREGULLORE PËR REGJISTRIMIN, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PRAKTIKANTËVE NË FUSHËN E INXHINIERISË

KAPITULLI I DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i procedurës për regjistrimin e praktikantëve të inxhinierisë në Odën e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Oda) dhe të drejtave dhe detyrimeve të tyre gjatë ushtrimit të punës praktike.

Neni 2 Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet për Odën, anëtarët e saj dhe praktikantët e inxhinierisë.

Neni 3 Përkufizimet

- Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:
 - 1.1. Praktikant i inxhinierisë** – Personi i cili zhvillon punë praktike në profesionin e inxhinierisë, pas përfundimit të studimeve akademike në fushën e inxhinierisë, me synim licencimin nga Oda.
- Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 08/L – 012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji në fuqi).
- Emrat në njërin gjini të përdorura në këtë Rregullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë tjetër, pa diskriminim.

KAPITULLI II PROCEDURA E REGJISTRIMIT TË PRAKTIKANTËVE TË INXHINIERISË NË ODË

Neni 4 Kushtet për regjistrim

1. Për regjistrim të punës praktike në Odë, aplikuesi plotëson në mënyrë kumulative kushtet në vijim:
 - 1.1. Është shtetas i Republikës së Kosovës ose posedon lejeqëndrim në Republikën e Kosovës;
 - 1.2. Ka të përfunduar studimet akademike në fushën e inxhinierisë dhe ka diplomën përkatëse;
 - 1.3. Përzgjedh inxhinierin e licencuar që është anëtar i Odës apo inxhinierin që i caktohet nga Oda, në mbikëqyrjen e të cilit do ta zhvilloj punën praktike, dhe
 - 1.4. Paguej taksën për regjistrim të punës praktike në Odë.

Neni 5 Aplikimi për regjistrim

1. Aplikimi për regjistrim të punës praktike në Odë paraqitet në formë elektronike, përmes ndërfaqës së sistemit elektronik të Odës.
2. Forma elektronike e aplikimit nga paragrafi 1 përcaktohet me vendim të Bordit Drejtues.
3. Përmes sistemit, aplikuesi vërteton duke ofruar të dhënat personale dhe fotografinë personale, apo ngarkuar dokumentet përkatëse, plotësimin e kushteve nga Neni 4.
4. Për vërtetimin e plotësimin të kushtit të përfundimit të studimeve përkatëse nga nën-paragrafi 1.2 i Nenit 4, aplikuesi paraqet diplomën nga institucioni arsimor i akredituar në Republikën e Kosovës, ose diplomën e nostrifikuar në Republikën e Kosovës të institucionit arsimor jashtë Republikës së Kosovës.
5. Plotësimi i kushtit nga nën-paragrafi 1.3 i Nenit 4, vërtetohet nga inxhinieri i licencuar që është përzgjedhur për mbikëqyrjen e praktikantit të inxhinierisë. Në rast se aplikuesi nuk ka zgjedhur inxhinierin mbikëqyrës, atëherë Oda i cakton aplikuesit inxhinierin në mbikëqyrjen e të cilit do të zhvilloj punën praktike.
6. Përcaktimi i inxhinierit mbikëqyrës nga Oda bëhet me rotacion për të përfshirë të gjithë inxhinierët e licencuar dhe bazuar në kriteret tjera të përcaktuara nga Bordi Drejtues, pa diskriminim.

7. Me rastin e aplikimit, sistemi elektronik gjeneron një vërtetim që dëshmon aplikimin, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëngjitura.

Neni 6

Shqyrtimi i aplikimit dhe vendimi për regjistrim

1. Komisioni Vlerësues i Odës shqyrton aplikimin për regjistrim dhe vendos për të në afat prej tridhjetë (30) ditë nga paraqitja e aplikimit.
2. Komisioni Vlerësues në bazë të të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura, vërteton plotësimin e kushteve për regjistrim të praktikantit të inxhinierisë dhe merr vendim për regjistrim të praktikantit të inxhinierisë apo refuzim të regjistrimit.
3. Në rast të aplikimit të paqartë ose i cili duhet të plotësohet, Komisioni kontakton aplikuesin për sqarime të mëtejshme apo plotësimin e aplikimit në një afat të arsyeshëm kohor.
4. Në rast të mos ofrimit të sqarimeve të nevojshme apo plotësimit të aplikimit sipas udhëzimeve të Komisionit dhe afatit të përcaktuar në paragrafin 3, Komisioni refuzon aplikimin.

Neni 7

E drejta në ankesë dhe shqyrtimi i saj

1. Kundër vendimit për refuzim të regjistrimit nga Komisioni Vlerësues, aplikuesi mund të paraqet ankesë Komisionit të Ankesave, në afat prej tridhjetë (30) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
2. Rregullat për paraqitjen e aplikimit për regjistrim nga Neni 5 zbatohen përshtatshëmrisht për rregullat për paraqitjen e ankesës.
3. Ankesa shqyrtohet në afat prej tridhjetë (30) ditë nga paraqitja e saj. Ky afat është kumulativ dhe zbatohet për procedurën e shqyrtimit nga Komisioni Vlerësues dhe nga Komisioni i Ankesave.
4. Në rast se vlerëson se ankesa është e papranueshme ose e pa bazuar, Komisioni i Ankesave e refuzon atë dhe vërteton vendimin e Komisionit Vlerësues. Në të kundërtën, Komisioni i Ankesave aprovon ankesën, anulon vendimin e Komisionit Vlerësues dhe merr vendim për regjistrim të praktikantit të inxhinierisë në Odë.
5. Vendimi i Komisionit të Ankesave është përfundimtar. Pala e pakënaqur me vendimin e Komisionit të Ankesave mund t'i drejtohet gjykatës kompetente.

Neni 8
Vendimi, kohëzgjatja e regjistrimit

1. Puna praktike sipas kësaj Rregulloreje regjistrohet për një periudhë një (1) ose dy (2) vjeçare, varësisht nga vitet e studimeve akademike përkatëse.
2. Praktikanti i regjistruar në Odë fiton cilësinë e anëtarit praktikant në Odë.

Neni 9
Kontrata e praktikës

Në mes të praktikantit të regjistruar në Odë dhe inxhinierit të licencuar që mbikëqyr punën praktike të praktikantit, lidhet kontratë me shkrim.

Neni 10
Kartela identifikuese dhe pagesa e taksës

1. Oda i lëshon praktikantit të regjistruar kartelën identifikuese, që është pronë e Odës dhe përdoret nga praktikanti i inxhinierisë për sa kohë është duke ushtruar punën praktike sipas kësaj Rregulloreje. Për lëshimin e kartelës mbahet shënim i veçantë.
2. Forma dhe përmbajtja e kartelës identifikuese përcaktohen me vendim të Bordit.
3. Praktikanti i inxhinierisë që dëmton ose humb kartelën identifikuese, ka të drejtë të pranoj kartelën e re, kundrejt pagesës që bëhet në përputhje me vlerën e përcaktuar në Rregulloren përkatëse.
4. Pas vendimit për plotësimin e kushteve për regjistrim, para se të lëshohet kartela identifikuese, aplikuesi paguan taksën për regjistrim sipas vlerave të përcaktuara me Rregulloren përkatëse.

Neni 11
Pezullimi dhe revokimi i regjistrimit

Rregullat për pezullimin dhe revokimin e licencës të inxhinierit zbatohen përshtatshëmrisht për pezullimin dhe revokimin e regjistrimit të praktikantit të inxhinierisë në Odë.

Neni 12
Ndërrimi i inxhinierit mbikëqyrës të praktikantit

1. Gjatë punës praktike, praktikanti i inxhinierisë ka të drejtë t'i paraqes kërkesë Komisionit Vlerësues të Odës për ndryshimin e inxhinierit që mbikëqyr punën praktike të praktikantit të inxhinierisë. Kjo kërkesë duhet të jetë e arsyetuar.

2. Kërkesa nga paragrafi 1 vërtetohet nga inxhinieri pasues i licencuar që është përzgjedhur për mbikëqyrjen e praktikantit të inxhinierisë.

3. Rregullat për shqyrtimin e aplikimit dhe nxjerrjen e vendimit për regjistrim zbatohen përshtatshmërisht në rastet e ndërrimit të inxhinierit mbikëqyrës të praktikantit të inxhinierisë.

Neni 13

Vërtetimi për përfundimin e punës praktike

1. Pas përfundimit të periudhës të punës praktike, praktikantit të inxhinierisë, me kërkesë të tij, i lëshohet vërtetimi për punën praktike nga Oda.

2. Përfundimi i punës praktike konfirmohet nga inxhinieri mbikëqyrës i praktikantit të inxhinierisë, para lëshimit të vërtetimit nga paragrafi 1.

KAPITULLI III

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PRAKTIKANTËVE TË INXHINIERISË

Neni 14

Të drejtat e praktikantit të inxhinierisë

1. Gjatë punës praktike, praktikanti i inxhinierisë ka të drejtë të zhvilloj veprimtarinë që i takon inxhinierit të licencuar në ushtrimin e profesionit të tij, por në mbikëqyrje të vazhdueshme nga inxhinieri i licencuar.

2. Projektet e përgatitura dhe shërbimet tjera nga praktikanti i inxhinierisë duhet të vlerësohen dhe konfirmohen nga inxhinieri i licencuar mbikëqyrës, para paraqitjes së tyre te palët e jashtme apo institucionet publike.

3. Praktikanti i inxhinierisë ka të drejtë të ndjek aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional të organizuara nga Oda, por pa fituar pikë kredituese.

4. Për punën praktike, praktikanti i inxhinierisë paguhet varësisht nga marrëveshja me inxhinierin e licencuar që mbikëqyrë punën e tij.

Neni 15

Detyrimet e praktikantit të inxhinierisë

1. Praktikanti i inxhinierisë në ushtrimin e veprimtarisë së tij kryen detyrat e profesionit me ndërgjegje dhe përgjegjësi në mënyrë profesionale, ligjore dhe etike.

2. Në zbatim të paragrafit 1, praktikanti i inxhinierisë është i detyruar të zbatoj Ligjin në fuqi, Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale, si dhe aktet tjera përkatëse të Odës.
3. Praktikanti i përgjigjet drejtpërdrejtë mbikëqyrësit të punës praktike të tij dhe Odës.
4. Praktikanti i inxhinierisë ka përgjegjësi disiplinore në rast të shkeljes së ligjit apo rregullave të përcaktuara në Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale.

KAPITULLI V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Kuvendi i Odës dhe publikohet në faqen elektronike të Odës.

Arsim Rapuca


Kryetar i Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës